



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.235/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Koalicioni Për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë; 30.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, Anr.235/2025, e datës 28.01.2025.
- II. Subjektit politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 7.500 (shtatë mijepesëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 28.01.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, bazuar në argumentet e paraqitura, duke kërkuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) që sipas parashtruesit të ankesës kjo ankesë synon të mbrojë të drejtat e barabarta të qytetarëve të Kosovës dhe të promovojë një mjedis zgjedhor të lirë nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes. Veprimet e Koalicionit për Familje janë një precedent i rrezikshëm që kërkon reagim të menjëhershëm dhe të vendosur nga institucionet përgjegjëse. Më tej thuhet në ankesë se kandidati Eman Rrahmani, nga radhët e subjektit politik Koalicioni për Familjen, deklaratën publike e ka bërë më datë 27 janar 2025, gjatë hapjes së fushatës zgjedhore, të cilën e ka postuar në rrjetin social Facebook, duke theksuar se *“Po thonë që nuk bon me ju thanë “ turp” atyre që cenojnë familjen . Turp edhe marre, secilit, organizatë jo qeveritare që financon në degjeneriminin e fëmijëve! Turp*

edhe marre secilës komunë e secilit kryetarë komune që i financon këto organizata, me e prish familjen!”, po ashtu deklaro se *“Nuk Lejohet tjetër martesë! Nuk do t’lejojmë martesë burrë me burrë e grua me grua sepse ja u ndalon ligji dhe nuk do te mund ta ndryshojnë asnjëherë në vendin tonë!...Andaj edhe njëherë ju beje thirrje të gjithave te angazhohemi dhe te punojmë që deri me 9 shkurt mbështetjen popullore ta fitojmë dhe vendin të gjithë atyre që familjen e cenojnë t’ua tregojmë”* Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që të konstatojë shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet nga Koalicioni për Familje dhe kandidatit Eman Rrahmani, të ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj Koalicionit për Familje dhe kandidatit të tij, për gjuhën nxitëse dhe diskriminuese, të kërkojë publikisht që Koalicioni për Familje të tërheqë deklaratat diskriminuese dhe të kërkojë falje publike ndaj komunitetit LGBTI+ dhe të sigurohet që subjektet politike të respektojnë standardet demokratike dhe ligjet në fuqi gjatë fushatës zgjedhore.

PZAP me datë 29.01.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje subjektit politik Koalicionit për Familje, mirëpo ky subjekt politik nuk është përgjigjur në afatin e paraparë deri më datë 30.01.2025, e as më vonë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, të cilat janë bërë nga Koalicioni për Familjen, respektivisht nga kandidati për deputet Eman Rrahmani në rrjetin social facebook, ku shihet se i njëjti, ka postuar deklaratat duke përdorur fjalët “Po thonë që nuk bon me ju thanë “ turp” atyre që cenojnë familjen . Turp edhe marre, secilit, organizatë jo qeveritare që financon në degjenerimin e fëmijëve! Turp edhe marre secilës komunë e secilit kryetarë komune që i financon këto organizata, me e prish familjen!”

Paneli, konform nenit 13 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.01/2024, me datë;25.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës duke shikuar postimin në rrjetin social në Facebook, dhe gjënë se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj, Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga subjektit politik Koalicioni për Familjen, përkatësisht, nga kandidati i këtij subjekti Eman Rrahmani, ndaj LGBTI+, në fushatë zgjedhore dhe rrjetin sociale Facebook, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve

politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është përdorur gjuha ndaj një komuniteti, faktin që deklaratat janë publikuar në rrjetin social Facebook, prandaj sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga kandidati për deputet sipas Panelit është shkelur etika zgjedhore dhe standardet e sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se fjalitë e përdora i referohen grupeve të caktuara dhe si të tilla përmbajnë elemente të nxitjes së urrejtjes, diskriminimi dhe cenim të drejtave të grupeve që u është referuar.

Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Shprehjet që përdorin fjalë si “turp” dhe “marre” për të sulmuar individë, grupe apo organizata të caktuara mund të krijojnë një atmosferë të pasigurt dhe të ndarë, duke shkelur kështu parimet e një fushate pozitive dhe të respektueshme.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje përkatësisht faktin se i njëjti subjekt edhe tri raste në këtë fushatë zgjedhore është dënuar për përdorim të gjuhës së urrejtjes, por përkundër kësaj ka vazhduar me përsëritjen e shkeljes. Në larësin e gjobës paneli ka marrë për bazë faktin se subjekti politikë në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.235/2025, datë 30.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.31/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazić kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Ragip Namani, anëtarë, lidhur me ankesën subjektivit politik, Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.235/2025, të datës 30.01.2025, në seancën e mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET si e themeltë ankesa e subjektivit politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) Anr.235/2025, të datës 30.01.2025, dhe vendoset ashtu që: Refuzohet e pathemeltë ankesa e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim, me seli në Prishtinë, Anr.235/2025, e datës 28.01.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.235/2025, të datës 30.01.2025, është vendosur: I. Pranohet e bazuar ankesa e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, Anr.235/2025, e datës 28.01.2025. II. Subjektivit politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 7.500 €. III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që Gjykata Supreme të anulojë gjobën e vendosur ndaj



Koalicioni për Familjen, ndërsa të njihen deklaratat e koalicionit, si shprehje e mbrojtur politike sipas nenit 10 të KEDNJ-së, dhe të rikonfirmohet rëndësia e lirisë së shprehjes në nxitjen e debatit demokratik.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.235/2025, e datës 28.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 28.01.2025 PZAP, ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, bazuar në argumentet e paraqitura, duke kërkuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) që sipas parashtresës të ankesës kjo ankesë synon të mbrojë të drejtat e barabarta të qytetarëve të Kosovës dhe të promovojë një mjedis zgjedhor të lirë nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes. Veprimet e Koalicionit për Familje janë një precedent i rrezikshëm që kërkon reagim të menjëhershëm dhe të vendosur nga institucionet përgjegjëse.

PZAP, më datë 29.01.2025, iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje subjektit politik Koalicionit për Familje, mirëpo ky subjekt politik nuk është përgjigjur në afatin e paraparë deri më datë 30.01.2025, e cila nuk ka paraqitur përgjigje.

PZAP-i, duke vepruar sipas ankesës, ka nxjerr vendimin Anr.235/2025, të datës 30.01.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim, me seli në Prishtinë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: „Paneli, pas shikimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, të cilat janë bërë nga Koalicioni për Familjen, respektivisht nga kandidati për deputet Eman Rrahmani në rrjetin social facebook, ku shihet se i njëjti, ka postuar deklaratat duke përdorur fjalët “Po thonë që nuk bon me ju thanë” turp” atyre që cenojnë familjen. Turp edhe marre, secilit, organizatë jo qeveritare që financon në degjenerimin e fëmijëve! Turp edhe marre secilës komunë e secilit kryetarë komune që i financon këto organizata, me e prish familjen!”.

Paneli, konform nenit 13 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.01/2024, me datë 25.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës duke shikuar postimin në rrjetin social në Facebook, dhe gjënë se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij,



ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: "1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj, Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga subjektit politik Koalicioni për Familjen, përkatësisht, nga kandidati i këtij subjekti Eman Rrahmani, ndaj LGBTI+, në fushatë zgjedhore dhe rrjetin sociale Facebook, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është përdorur gjuha ndaj një komuniteti, faktin që deklaratat janë publikuar në rrjetin social Facebook, prandaj sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga kandidati për deputet sipas Panelit është shkelur etika zgjedhore dhe standardet e sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se fjalitë e përdora i referohen grupeve të caktuara dhe si të tilla përmbajnë elemente të nxitjes së urrejtjes, diskriminimi dhe cenim të drejtave të grupeve që u është referuar.

Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Shprehjet që përdorin fjalë si "turp" dhe "marre" për të sulmuar individë, grupe apo organizata të caktuara mund të krijojnë një atmosferë të pasigurt dhe të ndarë, duke shkelur kështu parimet e një fushate pozitive dhe të respektueshme.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje përkatësisht faktin se i njëjti subjekt edhe tri raste në këtë fushatë zgjedhore është dënuar për përdorim të gjuhës së urrejtjes, por përkundër kësaj ka vazhduar me përsëritjen e shkeljes. Në larësin e gjobës paneli ka marr për bazë faktin se subjekti politikë në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.



Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP, lidhur me aprovimin e ankesës të parashtruar nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar në tërësi ankesën e parashtruar nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të vendimit të PZAP-së për arsye se:

Me provat që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë ankesa së bashku me dëshmitë e ofruara të paraqitura në PZAP, si dhe ankesa drejtuar kësaj gjykate, shihet qartë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: “1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës konkretisht dëshmitë e ofruara me ankesë shihet se kandidatët për deputetët të subjektit politik Koalicioni Për Familje, përkatësisht kandidatin për deputet Eman Rrahmani i cili në rrjetin social facebook, ka postuar deklaratat duke përdorur fjalët “Po thonë që nuk bon me ju thanë “turp” atyre që cenojnë familjen. Turp edhe marre, secilës, organizatë jo qeveritare që financon në degjenerimin e fëmijëve! Turp edhe marre secilës komunë e secilit kryetarë komune që i financon këto organizata, me e prish familjen!”..

Nga deklaratimet e cituara Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11 të LZP-së. Deklarimet dhe postimi i cituar gjatë fushatës nuk përmbajnë fjalor që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve. Përmes këtyre deklaratimeve dhe postimit kandidatët në fjalë shpalosin programin e tyre dhe kërkojnë mbështetjen duke ofruar atë që kanë në planë program gjatë fushatës zgjedhore, ndërsa fjalët të përdorua këtu nuk janë të drejtuara kundrejt një subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar, në mënyrë që të ngjall apo nxit urrejtje ndaj tyre. Në këto deklarim në asnjë moment nuk kemi thirrje apo nxitje që të ndërmerret veprime të caktuara kundër këtyre subjekteve caktuara.

Nga kjo rezulton se nuk po kërkohet nga qytetarët që të ndërmerret ndonjë veprim i caktuar kundër tyre, mirëpo këto kanë të bëjnë me zotimet në fushatë zgjedhore se nuk do t'i lejojnë nismat



legjislative sa i përket këtij komuniteti përmes veprimit demokratik, prandaj dhe pse këto qëndrime nuk i shkojnë përshtati ndonjë subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar, dhe shtu faktin se të njëjtat deklarime nuk i drejtohen qytetarëve për nxitje të urrejtjes apo me kërkesë që ndaj tyre të ndërmerret ndonjë veprim i caktuar, dhe nuk kemi ndonjë veprim apo fjalë e cila fyen apo ofendon të njëjtit, nuk mund të konsiderohen si nxitje e urrejtjes dhe shkelje e kodit të mirësjelljes, prandaj nga kjo rezulton se ankesa e parashtruar nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim me seli në Prishtinë, është e pabazuara.

Përveç të cekurave duhet theksuar se nëse i referohemi gjuha e urrejtjes sipas Strategjisë dhe Planit të veprimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara - OKB-së, rezulton se:

Nuk ka përkufizim universal apo të njëjtë rreth gjuhës se urrejtjes por nëse shikohet nga konteksti ndërkombëtar respektivisht nga OKB-ja, si organizata me e madhe botërore, atëherë gjuha e urrejtjes përkufizohet si: “Çdo lloj komunikimi në të folur, shkrim ose sjellje që sulmon ose përdor gjuhë poshtëruese ose diskriminuese duke iu referuar një personi ose një grupi në bazë të asaj se kush janë me fjalë të tjera bazuar në fenë, përkatësinë etnike, kombësinë, racën, ngjyrën, prejardhjen, gjininë ose faktor tjetër identiteti”.

Sipas Parimeve dhe Udhëzimeve për një qasje gjithëpërfshirëse për të luftuar gjuhen e Urrejtjes shtojcës së rekomandimit CM/REC (2022)16 të Këshillit të Evropës, gjuha e urrejtjes kuptohet si të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal, real ose të atribuar si “raca, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual”.

Në anën tjetër, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut - GJEDNJ, në praktiken e saj gjyqësore, lidhur me deklaratimet gjatë fushatës zgjedhore deri me tani ka trajtuar një sërë çështjesh në lidhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj-Konventës.

GJEDNJ, ka theksuar se ekziston një lidhje të ngushtë ndërmjet të drejtës për zgjedhje të lira dhe lirisë së shprehjes. Në rastin Bowman kundër Mbretërisë së Bashkuar, ka theksuar se këto të drejta, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku përbëjnë themelin e çdo sistemi demokratik. Të dy këto të drejta janë të ndërlidhura dhe funksionojnë për të përforcuar njëra-tjetrën: për shembull, liria e shprehjes është një nga “kushtet” e nevojshme për të “siguruar shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës”. Zgjedhjet e lira dhe liria e shprehjes, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku përbëjnë themelin e çdo sistemi demokratik. Për këtë arsye, është veçanërisht e rëndësishme në periudhën para zgjedhjeve që opinionet dhe informacionet e të gjitha llojeve të lejohen të qarkullojnë lirisht.

Me tej, GJEDNJ, në rastin Vajnai kundër Hungarisë, ka theksuar se: kur liria e shprehjes ushtrohet si fjalim politik, kufizimet justifikohen vetëm për aq sa ekziston një nevojë e qartë, urgjente dhe specifike sociale. GJEDNJ, rithekson se: ka pak hapësirë sipas nenit 10 paragrafit 2 të Konventës



për kufizime në fjalimin politik ose në debatin e çështjeve me interes publik. Për me tepër, kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjera për një politikan si të tillë sesa për një person privat. Ndryshe nga ky i fundit, i pari në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije është i hapur ndaj një kontrolli të ngushtë të fjalëve dhe veprave të tij nga gazetarët dhe publiku i gjerë, dhe rrjedhimisht ai duhet të shfaqë një shkallë më të madhe tolerance, (Feldek kundër Sllovakisë).

Po ashtu, gjykata në rastin Nilsen dhe Johnsen kundër Norvegjisë, ka ritheksuar më tej se: liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për vetë përmbushjen e çdo individi. Andaj, edhe pse liria e shprehjes mund t'i nënshtrohet përjashtimeve, ato "duhet të interpretohen ngushtë" dhe "domosdoshmëria për çdo kufizim duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse".

Duhet theksuar se me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: "1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare".

Andaj në kontekstin e paraqitur duke ju referuar të cekurave më lart, rezulton se: në këtë rast shpalosja e një programi politik, i cili synon që të "mbrojë", një vlerë sikur ata pretendojnë në kontekst të ndryshimeve ligjore që propozohen në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet si gjuhë e urrejtjes, përçarjes apo mos durimit, e aq më pak shkelje e rregullave të fushatës zgjedhore, pasi nga shprehjet e përdorura nuk plotësohen elementet bazë të gjuhës së urrejtjes, sepse nuk rrezikohet statusi i kësaj kategorie personash, nuk rrezikohet siguria fizike, e aq më pak ekzistenca e tyre. Pra ky subjekt politik në programin dhe kauzën zgjedhore me të cilën garon e ka premtimin se ligjet të cilat sipas tyre "rrezikojnë", familjen nuk do të marrin aprovimin e tyre në kuvend dhe se ata në mënyrë demokratike dhe ligjore do të bëjnë përpjekje për këtë dhe jo përmes formave jo demokratike.

Kategorizimi i shprehjeve të përfaqësuesve të këtij subjekti politik shprehur në fushat si gjuhë e urrejtjes është kategorizim jo adekuat e madje subjektin politik e vendos në pozitë të pafavorshme në raport me subjektet tjera politike sepse cenon frymën demokratike të fushatës e madje nëse është i pabazë kuptohet si cenim i lirisë së shprehjes.

Pozicionet e subjekteve politike përmes fushatës, pastaj edhe gazetarët lejohen në një masë ti shprehin bindjet dhe veprimtarin e tyre në emër të lirisë së shprehjes si e drejte fundamentale.

Për t'u kategorizuar një shprehje si gjuhë e urrejtjes duhet të plotësohen edhe elementi i cenimit të diskriminimit apo cenimit të sigurisë përmes pasojave që mund të ketë grupi apo individët brenda grupit.

Në këtë rast me infrastrukturën ligjore në fuqi është përcaktuar se martesë është në mes të dy personave me seks të ndryshëm, pra martesë mes personave të seksëve të njëjta nuk është e njohur,



pra dhe mbrojtja e këtij qëndrimi nuk nënkupton në mënyrë automatike sidomos kur programi politik është i certifikuar nga institucionet përkatëse.

Shprehjet e tilla janë në kuadër të shprehjeve brenda kornizës së rregullave të të shprehurit, nuk nxisin, e as nuk promovojnë urrejtje, mos durim, e as dhunë, e as nuk cenojnë funksionimin e tyre apo ushtrimin e të drejtave të tyre brenda shoqërisë pavarësisht orientimit të tyre seksual.

Rregullat demokratike në një vend garantojnë fushatë demokratike me programe të qarta për të kërkuar votën e votuesit. Mirëpo në rast se të kishin shprehjen: “Me ardhjen tonë në pushtet këta nuk do të kenë vend në shoqërinë tonë, apo se këta nuk janë persona të mirëseardhur në vendin tonë e shprehje tjera të ngjashme”, është situatë tjetër, si të atilla do të pasqyrojnë gjuhë të urrejtjes dhe mos durimit. Në këtë kontekst përpjekja për një rregullim ligjor nuk mund të kuptohet si gjuhë e urrejtjes në asnjë rast, sepse shprehjet e përfolura derivojnë nga programi politik e të cilat synohet të normohen në ligj nëse votuesi i akcepton si të tilla.

Pra rregullat demokratike zgjedhore përcaktojnë garë zgjedhore me programe politike, dhe se ky standard i krijuar nga PZAP, në të ardhmen mund të shërbej si precedent që nëse në të ardhmen, një subjekt politik kërkon që me ligj të njihet “Martesa me sekse të njëjta”, prapa të përben gjuhë të urrejtjes përball pjesës tjetër që nuk është e një mendimi të tillë. Pra secila vendimarrje duhet me qenë e matur përball frymës që dëshirojmë që ta kemi në demokracinë zgjedhore.

Nga të cekurat me Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se: derisa nuk mund të ndalohen të drejtat e një subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar që në mënyrë të lirshme ti shpreh bindjet e tyre dhe veprimtarinë e saj, po ashtu nuk mund të sanksionohet një subjekt politik i cili mban qëndrim të kundërt kundrejt tyre, pa pasur ndonjë element të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët. Që të vie në shprehje shqiptimi i gjobës duhet të vërtetohet fakti se i njëjti subjekt me veprimet, apo fjalimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore, nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve. Prandaj në këtë rast PZAP, nuk ka arritur të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike dhe nuk e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk rezulton se kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, prandaj ankesa e subjektit politik është aprovuar si e bazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është ndryshuar.

Gjykata Supreme vlerësoi ankesën sa i përket lejushmërisë së saj dhe vendosi që e njëjta të trajtohet si e afatshme, për faktin se subjekti politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, vendimin e PZAP-së, e ka pranuar më datë 31.01.2025 në ora 14:36h, ndërsa ankesën në Gjykatën Supreme e ka dorëzuar më datë 03.02.2025, mirëpo duke marrë parasysh se afati i fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë më datë 02.02.2025, ditë e diele, në të cilën ditë nuk punon gjykata, vlerësoi se ankesa është e afatshme dhe vendosi ta trajtoj të njëjtën në bazë të meritave.



Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, dhe 34 paragrafi 1 pika 1.11, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr.31/2025 datë 05.02.2025.

Kryetar i kolegjit,

Nenad Lazić



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
SAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshirë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fëmijë, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određenom vremenu u svom stani radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćina, Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës; ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odušno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stan - radnom mestu primaoca (pribreno na vratima stana odušno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
data _____ u _____
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca



SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PRISTINE

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-31/2025

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT6-1116/14

05.07.2025

Numri i shtojcave:
broj priloga

2

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavenog pisma
(i slovima)

07.02.2025

Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismo primilo u zamenu

16:20

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është primilac ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzues, duhet shkruar shkruar pse marrësi nuk e ka vend nënshkrimin e vet. Ako je primilac neprimar ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostiljac. Napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Priloga